



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 143, Datë 16.06.2021

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S MBI KËRKESËN E SHOQËRISË W.T.S -ENERGJI SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 16, SERIA PV04P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 39, DATË 22.07.2004, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 92/1 prot, datë 14.06.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi “Kërkesën e shoqërisë “W.T.S - ENERGJI” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës Nr.16, Seria PV04P, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 117, datë 04.05.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “W.T.S – Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës Nr. 16, Seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.07.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 26, datë 09.04.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 07.10.2013, të bordit të ERE-s.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me Njoftimin për Modifikim Licence nr. 6/13 prot., datë 04.05.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “W.T.S Energji” sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 617/3 prot., datë 11.06.2021, shoqëria “W.T.S - ENERGGJ” sh.p.k. paraqiti kërkesën për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE-s, për të mundësuar paraqitjen e disa dokumentave dhe argumentave shtesë të kërkuara në përputhje me rregulloren e sipërcituar.
- Kërkesa e “W.T.S – ENERGGJ” sh.p.k., rezulton e depozituar brënda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative”, i cili përcakton se “*Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit*”.
- Po ashtu Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, në nenin 14, pika 3, të saj përcakton se: “*Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune*”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “W.T.S – ENERGGJ” sh.p.k., për modifikimin e licencës Nr.16, Seria PV04P në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**